

Formular për SYLLABUS të Lëndës: Analizë statistikore,dhe Ekonomike
2020/2021

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Analizë statistikore dhe ekonomike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	E obligueshme (O)
Viti i studimeve:	Viti i Dytë, Semestri i Tretë
Numri i orëve në javë:	2L+1U
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënës të lëndës:	Prof. Dr. Ramije Mustafa Topxhiu, rahmije.topxhiu@uni-pr.edu Prof. Asoc. Dr. Ardiana Gashi ardiana.gashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Lënda “Analiza statistikore” përfshin trajtimin e çështjeve, gjegjësisht metodave dhe teknikave me të cilat mund të bëhet analiza statistikore e fenomeneve të ndryshme ekonomike dhe shoqërore. Lënda do të trajtojë më gjerësisht teorinë e probabilitetit dhe shpërndarjet teorike duke vënë theksin te shpërndarja normale. Gjithashtu do të trajtohen metodat përmes të cilave bëhet vlerësimi i parametrevë të tërësisë së përgjithshme përmes mostrës: si intervalet e besimit dhe testimi i hipotezave. Rëndësi do t’i kushtohet analizës së regresionit dhe korrelacionit, duke pasqyruar aplikimin e shumtë të kësaj metode në shumë sfera.
Qëllimet e lëndës:	-Zgjerimi i njohurive të fituara në bazat e statistikës; - Zgjerimi i njohurive rreth teorisë së probabilitetit dhe shpërndarjeve teorike të probabilitetit; -Aftësimi i studentëve për të bërë vlerësimin përmes intervaleve të besimit dhe testimit të hipotezave; - Aftësimi i studentëve për të performuar analizën e regresionit dhe korrelacionit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të: - Kuptojnë rolin dhe rëndësinë e analizës statistikore për marrjen e vendimeve në sfera të ndryshme ekonomike, shoqërore dhe personale. - Aplikojnë shpërndarjet probabilitare të ndërprera dhe të vazhdueshme për të llogaritur probabilitetin e ndodhjes së një apo më shumë ngjarjeve. - Analizojnë dhe debatojnë argumentet statistikore si ato që

	gjinden në publikime shkencore dhe më mediet e popullarizuara. - Vlerësojnë dhe komunikojnë parametrat e popullimit përmes intervaleve të besimit dhe testimit të hipotezave për një mostër të vetme dhe për rastet e dy mostrave të dy popullimeve; - Vlerësojnë se sa e fortë është evidenca (dëshmia) e marrëdhënies midis dy ose më shumë ndryshoreve dhe të parashikojnë efektin e ndryshimit në një variabël bazuar në ndryshimet e variablave të tjerë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	8
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokviume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	3	10	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	11	33
Përgaditja përfundimtare për provim	-	-	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet ,etj	-	-	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Për të arritur një nivel të kënaqshëm të mësim nxënies efektive, do të përdoren metoda të kombinuara të mësimdhënies në mënyrë të balancuar me qëllim që të përmbushen kriteret e të nxënit. Fillimisht do të përcaktohen qartë objektivat mësimore si dhe studentëve do t’u sqarohet shumë qartë se çfarë pritet prej tyre. Gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve do të përdoret mësim aktiv me qëllim që të mbahet gjallë vëmendja e studentëve gjatë orës së mësimi duke iu dhënë atyre në mënyrë të herëpashershme për të bërë ushtrime në grupe të vogla. Pasi të jenë formuar grupet, atyre do tu shtrohen pyetje ose do të vihet në diskutim një problem i shkurtër të cilin ata duhet ta zgjidhin ose të dhënë përgjigje në pyetjet e parashtruara. Duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimet në klasë dhe në kryerjen e detyrave në klasë, çdo student do të përmirësojë komunikimin dhe aftësitë analitike nëpërmjet të mësuarit të koncepteve statistikore dhe aplikimeve të tyre në biznes dhe		

	ekonomi. Duke plotësuar detyrat e shtëpisë, çdo student do të rrisë aftësitë analitike, si dhe do të përmirësojë aftësitë dhe shkathhtësitë duke përdorur Microsoft Excel për futjen e të dhënave dhe analizën e tyre.	
Metodat e vlerësimit:	▪ Pjesëmarrja aktive - 5% ▪ Detyrat e shtëpisë – 10% ▪ Kollokviumi i parë – 40% ▪ Kollokviumi i dytë - 45%, ose Provimi përfundimtar me shkrim (ose edhe me gojë) -85%	
Literatura		
Literatura bazë:	Rahmije Mustafa Topxhiu: <i>HYRJE NË STATISTIKË</i> , Prishtinë, 2016	
Literatura shtesë:	- Prem S. Man, <i>Introductory Statistics</i>, Seventh Edition, John Wiley & Sons, 2010, USA, - Douglas A. Lind. William G. Marchal, Samuel A. Wathen, (2013), <i>Basic Statistics for Business & Economics</i>, Eighth Edition, McGraw-Hill/Irwin, International Edition, New York. - David R. Anderson, Dennis J. Sweeney, Thomas A. Williams, (2013), <i>Statistika për biznes dhe ekonomik</i>, UET press, Tiranë. - Milan Papiq, <i>Statistika e aplikuar në MS Excel</i>, (2007) përkthim nga kroatishja, Kolegji Universitar “Victory”. Prishtinë - Ajet Ahmeti, <i>Statistikë për biznes dhe ekonomiks</i>, 2016.	
Plani i dizajnuar i mësimi:		Libri : <i>Hyrje në Statistikë</i>
Java	Ligjërata që do të zhvillohet	Faqe
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, Metodat e punës dhe vlerësimit; Obligimet e dyanshme student-mësimdhënës).	
Java e dytë:	Kapitulli 1. Menaxhimi i të dhënave (mbledhja e të dhënave, burimet e të dhënave, llojet e të dhënave, etj).	19-61
Java e tretë:	Kapitulli i 8. Metodat e zgjedhjes/mostrës.	319-347
Java e katërt:	Kapitulli 3 dhe 4. Statistika deskriptive –përshkruese (matësit e tendencës qendrore dhe variacionit).	121-189
Java e pestë:	Kapitulli 5. Një vështrim mbi konceptet bazë të probabilitetit.	195-242
Java e gjashtë:	Kapitulli 6. Variablat e rastit dhe modelet e shpërndarjeve probabilitare- Shpërndarjet probabilitare të ndërprera.	243-275
Java e shtatë:	Kapitulli 7. Shpërndarjet probabilitare të vazhdueshme- Shpërndarja normale dhe shpërndarja standarde normale	279 -315
Java e tetë:	Kapitulli 9. Shpërndarjet probabilitare të mostrave.	347-380
Java e nëntë:	Kapitulli 10. Vlerësimi dhe intervalet e besueshmërisë për mesataren aritmetike të popullacionit.	383-404

Java e dhjetë:	Kapitulli 10. Vlerësimi dhe intervalet e besueshmërisë për përpjesën e popullacionit.	405-423
Java e njëmbëdhjetë:	Kapitulli 11. Testimi i hipotezave rreth parametrave të popullimit I.	425-458
Java e dymbëdhjetë:	Kapitulli 11. Testimi i hipotezave rreth parametrave të popullimit II.	460-490
Java e trembëdhjetë:	Kapitulli 12. Analiza e regresioni dhe korrelacionit të thjeshtë linear I.	497-527
Java e katërbëdhjetë:	Kapitulli 12 Analiza e regresioni dhe korrelacionit të thjeshtë linear II.	526-557
Java e pesëmbëdhjetë:	Hyrje ne analizën e regresionit të shumëfishtë -leximi dhe interpretimi i rezultateve nga regresioni i shumëfishtë përmes shembujve.	

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
- Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në ligjërata dhe në ushtrime; - Respektimi i orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve. - Ç'kyçja e telefonave celular dhe mbajtja e qetësisë në mësim.	